

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“NAKO SPORTS MANAGEMENT” sh.p.k**

Sot ne daten 02.04.2024 bazuar ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” ortaku:

Fjodor Nako i datelindjes 13.12.1979, lindur ne Tirane, e banues ne Tirane, me nr personal H91213087R, vendosi te themeloje shoqerine

**“NAKO SPORTS MANAGEMENT” sh.p.k**

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar quhet **“NAKO SPORTS MANAGEMENT” sh.p.k.** dhe e ka seline ne adresen Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, shkalla 16, apartamenti 40.

**NENI 2**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Menaxhim i eventeve sportive, menaxhimi i sportistev dhe te gjitha veprimtarite dhe shërbimet që ligji u lejon shoqërive tregtare pa asnjë kufizim.

**NENI 3**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike dhe financiare te shoqerise me pergjegjes te kufizuar **“NAKO SPORTS MANAGEMENT” sh. p. k** do te jete pa afat.

**NENI 4**

Kapitali themelues i shoqerise 100 000 (njqind mije), i shprehur ne 1 kuote me vlere 100,000 leke, i kontribuar nga ortaku:

**Fjodor Nako                    1 kuote me vlere 100,000 Leke.**

Ky kapital mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marri ortaku.

## **NENI 5**

Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“NAKO SPORTS MANAGEMENT” sh.p.k**, do te jete Fjodor Nako i datelindjes 13.12.1979, lindur ne Tirane, e banues ne Tirane, me nr personal H91213087R, per nje periudhe 5 vjecare.

## **NENI 6**

Administratori i shoqerise se lartpermendur, eshte i veshur me te gjitha atributet per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim dhe kufizim. Ai ka mundesi te perpiloje te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ai ka te drejte te bleje dhe te kembeje pasuri, te lidhet me shoqeri te tjera. Ai kryen cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shtetore dhe private qe kane te bejne me garancite dhe veprimet hipotekore.

Te gjitha ketotribute do te shoqerohen rast pas rasti me autorizim te vecante nga ana e ortakëve te vetem dhe vetem ne kete menyre veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.

## **NENI 7**

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec urdhrave te vecanta qe jepen nga ortaku i vetem. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me rezultatin ekonomik, fitim-humbje, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiscal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem te shoqerise. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor, ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve te ndryshme per shoqerine si ate te akumulimit, te rezerves etj.

## **NENI 8**

Administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie ekonomiko-financiare me autorizim te ortakut te vetem, me persona fizike dhe juridik, vendas apo te huaj, mbi bazen e kontratave, bazuar ne legjislacionin Shqiptar.

## **NENI 9**

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lekun.

Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

**NENI 10**

Marredheniet e shoqerise me personelin e saj do te rregullohen mbi bazen e legjislacionit te punes. Shoqeria ka te drejte te pushoje cdo punonjes te personelit nga puna per shkak te indisiplinimit ose paaftesise profesionale duke kerkuar gjithashtu demshperblimin per demin e shkaktuar shoqerise nga punonjesit per faj te tyre.

**NENI 11**

Ne rast prishje te shoqerise, ortakët e vetem cakton nje likujdator i cili ne fund te likujdimit paraqet bilancin e likujdimit.

**NENI 12**

Ky akt themelimi hartohet ne kater kopje me vlere te barabarte secila.

ORTAKU I VETEM

**FJODOR NAKO**

